

6. MONITORIMI I RREZIQEVE NDAJ TË CILËVE EKSPONOHET SEKTORI BANKAR VENDAS

6.1 RREZIQET E TREGUT

6.1.1 RREZIKU I KURSIT TË KËMBIMIT

PËRBËRJA E BILANCIT SIPAS VALUTAVE DHE POZICIONI I HAPUR NETO NË VALUTË

Në gjysmën e parë të vitit 2011, aktivet e sektorit bankar në valutë arritën nivelin rreth 548 miliardë lekë, duke shënuar rritje me 4.3% në krahasim me fundin e vitit 2010 kundrejt ritmit rritës prej 7.8% në gjysmën e parë të vitit 2010. Bankat e Grupit 3 përfaqësonin 65.1% të totalit të aktiveve në valutë. Detyrimet në valutë arritën në nivelin 525.4 miliardë lekë, duke u rritur me 4% në krahasim me fundin e vitit 2010 kundrejt rritjes prej 6.5% në gjysmën e parë të vitit 2010. Bankat e Grupit 3 përfaqësonin 65.3% të vlerës së përgjithshme të detyrimeve në valutë.

Aktivët e sektorit bankar në valutë zinin rreth 52.5% të totalit të aktiveve, 0.6 pikë përqindje më pak se në fund të vitit 2010. Detyrimet e sektorit bankar në valutë të huaj ishin rreth 50.3% të totalit të bilancit, 0.7 pikë përqindje më pak se në muajin dhjetor 2010. Diferenca ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve në valutë ka arritur vlerën më të lartë të viteve të fundit me rreth 2.2 pikë përqindje, ndonëse vlerësohet ende në nivele të kufizuara.


Tabelë 19. Pësja e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj totalit të aktiveve të sektorit bankar, në përqindje (dhjetor '05 – qershor '11)

Pësja ndaj totalit të aktiveve të sektorit bankar (në përqindje)			
Periodha	Aktive në valutë	Detyrime në valutë	Diferenca (1)-(2)
Dhjetor 2005	41.1	41	0.1
Mars 2006	41.5	41	0.5
Qershor	41.6	41.6	0
Shtator	43.3	43.2	0.1
Dhjetor	44.2	44	0.2
Mars 2007	45.6	45.2	0.4
Qershor	45.7	45.7	0
Shtator	46.6	46.5	0.1
Dhjetor	46.8	46.9	-0.1
Mars 2008	47.9	47.7	0.2
Qershor	48	48.1	-0.1
Shtator	50.6	50.2	0.4
Dhjetor 2008	48.9	48.5	0.4
Mars 2009	50.2	49.7	0.6
Qershor	48.4	47.5	0.9
Shtator	49.5	48.3	1.2
Dhjetor 2009	50.2	48.9	1.3
Mars 2010	50.9	49.3	1.6
Qershor 2010	51.3	49.4	1.9
Shtator 2010	52	50.2	1.8
Dhjetor 2010	53.05	51	2.05
Mars 2011	52.3	50.2	2.1
Qershor 2011	52.5	50.3	2.2

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në fund të muajit qershor të vitit 2011, pozicioni i hapur neto në valutë zinte rreth 3.7% të kapitalit regullator të sektorit bankar nga rreth 5% në fund të vitit 2010. Ky pozicion mbetet “në blerje” dhe brenda intervalit 0-10%, ku është luhatur në vitet e fundit.

Grafik 64. Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit për sektorin bankar dhe grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit



Madhësia e pozicionit të hapur konsiderohet e kufizuar, dhe si rezultat, rreziku direkt i kursit të këmbimit për bankat, vlerësohet i moderuar. Sipas grupeve të bankave, përgjithësisht bankat e grupeve 1 dhe 2 janë zhvendosur në një pozicion “në shitje” gjatë muajve të parë të vitit, ndërkohë, që bankat e grupit 3 kanë thelluar pozicionin e tyre “në blerje”.

Hapësirë informuese 6. Indeksi i modifikuar i mospërputhjeve valutore.

Ky indeks është një tregues i ri i bazuar në metodologjinë e ofruar nga ekspertët e FMN-së Romain Ranciere, Aaron Tornell dhe Athanasios Vamvakidis në studimin e tyre me titull “A New Index of Currency Mismatch and Systemic Risk”. Indeksi mundëson një matje më të plotë të ekspozimeve që bankat kanë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Ndryshe nga indekset e mëparshme, indeksi i ofruar nga Ranciere, Tornell dhe Vamvakidis përfshin edhe rrezikun indirekt të kredisë nëpërmjet kursit të këmbimit, i cili gjatë krizës financiare pësoi një rritje të konsiderueshme.

Për llogaritjen e këtij indeksi, autorët përdorin formulën në vijim:

$$\text{Pasive të pambuluara neto në valutë} / \text{Totali i aktiveve} = \{ [\text{detyrime jorezidente në valutë} + \text{detyrime rezidente në valutë}] - [\text{aktive jorezidente në valutë} + \text{aktive rezidente në valutë}] + [\text{hua e pambuluar në valutë për individë} + \text{hua e pambuluar në valutë për biznese}] \} / [\text{totali i aktiveve bankare}]$$

Formula e ofruar më sipër është diferenca mes aktiveve dhe pasiveve në valutë, duke i shtuar huanë e pambuluar në valutë, për t’u llogaritur më pas si përqindje ndaj totalit të aktiveve. Në Raportet e Stabilitetit Financiar kjo diferencë është vlerësuar, duke i zbritur aktiveve vlerën e pasiveve. Për këtë arsye, jemi munduar të ruajmë të njëjtën logjikë, duke i bërë disa ndryshime formulës së ofruar. Vlerat absolute


të mospërputhjes valutore mbeten të njëjta, por shenja ndryshon në "negative". Në këtë mënyrë, del më qartë se detyrimet në valutë janë më të larta se aktivet në valutë (pasi këto të fundit korrighohen/pakësohen për vlerën e kredisë së pambuluar). Nënçmimi i kursit të këmbimit, në këtë rast do të kishte ndikim negativ mbi bilancin e bankës, i cili do t'i bashkëngjitej efekteve të rrezikut indirekt të kredisë dhe më tej, mundësisë së përcjelljes në gjendjen e likuiditetit.

Formula e re është transformuar si më poshtë:

$$\text{Pasive të pambuluara neto në valutë të transformuar} / \text{Totali i Aktiveve} = \{[\text{aktive jorezidente në valutë} + \text{aktive rezidente në valutë}] - [\text{detyrime jorezidente në valutë} + \text{detyrime rezidente në valutë}] - [\text{hua e pambuluar në valutë për individ} + \text{hua e pambuluar në valutë për biznese}]\} / [\text{totali i aktiveve bankare}].$$

Grafik 65. Indeksi i mospërputhjes valutore


Indeksi i Mospërputhjes Valutore i Modifikuar



Grafiku në vijim paraqet ecurinë tremujore të treguesit për sektorin bankar. Gjatë gjashtëmuajorit të parë 2011 evidentohet rënie e indeksit nga -15.4%, që shënonte në fund të vitit 2010, në -16.7% në fund të qershorit 2011. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, indeksi ka pësuar rënie me 0.01 pikë përqindje.

Në vijim paraqitet grafiksht ecuria e përbërësve të indeksit të mospërputhjes valutore, gjatë periudhës janar 2008 – qershor 2011.

Grafik 66. Ecuria e përbërësve të indeksit të mospërputhjeve valutore



6.2.2 RREZIKU I NORMËS SË INTERESIT


PËRBËRJA SIPAS AFATIT TË MATURIMIT

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2011, ndaj aktiveve të sektorit bankar u llogarit një afat maturimi⁵⁰ mesatar i mbetur prej 30.1 muajsh, nga 29.5 muaj në fund të vitit 2010. Në të njëjtën periudhë, maturimi⁵¹ mesatar i mbetur i pasiveve të sektorit bankar ishte rreth 11.5 muaj, nga 12.1 muaj në fundin e vitit. Ecuria e maturimit mesatar të aktiveve dhe pasiveve paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Sikurse evidentohet dhe grafikisht, analizohet thellimi i hendekut midis maturimit mesatar të mbetur të aktiveve dhe pasiveve në rreth 18.5 muaj nga 17.3 muaj që ishte kjo diferencë në fund të vitit 2010. Në një hark kohor prej 5-vjetësh diferenca në maturim midis aktiveve dhe pasiveve është thelluar me rreth 1.8 muaj krahasuar me mesataren historike.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2011, kredia paraqet afat maturimi mesatar⁵² prej rreth 43.7 muaj, nga 44.5 muaj një gjashtëmujor më parë. Ndërkohë, referuar të njëjtës periudhë,

Grafik 67. Maturimi mesatar i mbetur i aktiveve dhe pasiveve në muaj



Burimi: Banka e Shqipërisë


⁵⁰ Është llogarit mesatarja e ponderuar e shpërndarjes së aktiveve, sipas kategorive të raportuara të maturimit. Për çdo interval është marrë "apriori", një vlerë pranë mesit të tij. Konkretisht, për intervalin që përfshin aktivet me maturim të mbetur "0-7 ditë", kohëzgjatja mesatare është marrë 3.5 ditë; për atë "7 ditë deri në 1 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 18.5 ditë; për atë "1-3 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 2 muaj; për atë "3-6 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 4.5 muaj; për intervalin "6-12 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 9 muaj; për intervalin "1-5 vjet", kohëzgjatja mesatare është marrë 36 muaj; për intervalin "mbi 5 vite", kohëzgjatja mesatare është marrë 10 vite ose 120 muaj (duke qenë së pjesa më e madhe në këtë segment përfaqësohet nga kreditë hipotekare me maturim fillestar 15 vjet).

⁵¹ Është llogarit mesatarja e ponderuar e shpërndarjes së pasiveve, sipas kategorive të raportuara të maturimit. Për çdo interval është marrë një vlerë pranë mesit të tij. Konkretisht, për intervalin që përfshin pasivet "0-7 ditë", kohëzgjatja mesatare është marrë 3.5 ditë; për atë "7 ditë-1 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 18.5 ditë; për atë "1-3 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 2 muaj; për atë "3-6 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 4.5 muaj; për atë "6-12 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 9 muaj; për intervalin "1-5 vjet", kohëzgjatja mesatare është marrë 36 muaj; për intervalin "mbi 5 vite", kohëzgjatja mesatare është marrë 6 vite ose 72 muaj.

⁵² Është llogarit mesatarja e ponderuar e shpërndarjes së kredisë, sipas kategorive të raportuara të maturimit. Për çdo interval është marrë "apriori", një vlerë pranë mesit të tij. Konkretisht, për intervalin që përfshin kreditë "deri në 7 ditë", kohëzgjatja mesatare është marrë 3.5 ditë; për atë "7 ditë -1 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 18.5 ditë; për atë "3-6 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 4.5 muaj; për intervalin "6-12 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 9 muaj; për intervalin "1-5 vjet", kohëzgjatja mesatare është marrë 36 muaj; për intervalin "mbi 5 vjet", kohëzgjatja mesatare është marrë 10 vjet ose 120 muaj.


depozitat shfaqin afat maturimi mesatar⁵³ prej 4.5 muajsh, krahasuar me 4.9 muaj në fund të gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2010.

Grafik 68. Maturimi mesatar i mbetur i kredisë



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 69. Maturimi mesatar i mbetur i depozitave



Burimi: Banka e Shqipërisë

Mospërputhja midis aktiv-pasiveve të ndjeshme ndaj normës së interesit

Aktivet dhe pasivet e ndjeshme ndaj normës së interesit vijojnë të paraqiten në vlera të përafërta edhe në fund të gjashtëmuajorit të parë të vitit 2011. Diferenca mes tyre për periudhën deri në 1 muaj paraqitet pozitive, përkatësisht me 6.2 miliardë lekë. Diferenca e aktiveve dhe pasiveve deri në 3 muaj dhe 12 muaj paraqitet negative respektivisht në vlerat -82.7 miliardë lekë dhe -50.1 miliardë lekë. Diferenca negative në afatet kohore të mësipërme sinjalizon krijimin e kostove neto shtesë për sektorin bankar në rastin e rritjes së normës së interesit, gjë e cila do të ndikojë negativisht në rezultatin financiar e rrjedhimisht në treguesit e kapitalit. Gjithsesi, madhësia e ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit vlerësohet nga peshat në përqindje të diferencave të mësipërme ndaj totalit të aktiveve, të cilat llogariten në vlera jomateriale.

6.2.3 RREZIKU I KREDITIT

Për të vlerësuar madhësinë e rrezikut të kreditit në veprimtarinë bankare, fillimisht analizohet ecuria e aktiveve dhe zërave jashtë bilancit me rrezik paralelisht me ecurinë e totalit të aktiveve⁵⁴. Në fund të gjashtëmuajorit të parë të vitit 2011, aktivet me rrezik⁵⁵ të sektorit bankar, ishin në nivelin 618.7 miliardë lekë ose 59.3% e totalit të aktiveve, ndërsa ato me normë ponderimi të rrezikut prej 0% (aktive pa rrezik) ishin në nivelin 439.3 miliardë lekë ose 42.1% e vlerës së paponduar të aktiveve të

⁵³ Është llogaritur mesatarja e ponderuar e shpërndarjes së depozitave, sipas kategorive të raportuara të maturimit. Për çdo interval është marrë "apriori", një vlerë pranë mesit të tij. Konkretisht, për intervalin që përfshin depozitat "deri në 7 ditë", kohëzgjatja mesatare është marrë 3.5 ditë; për atë "7 ditë-1 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 18.5 ditë; për atë "3-6 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 4.5 muaj; për intervalin "6-12 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 9 muaj; për intervalin "1-5 vjet", kohëzgjatja mesatare është marrë 36 muaj; për intervalin "mbi 5 vjet", kohëzgjatja mesatare është marrë 6 vjet ose 72 muaj.


⁵⁴ Ecurinë e totalit të aktiveve dhe totalit të aktiveve me rrezik e kemi paraqitur në formën e raportit ndaj një periudhe bazë (në rastin tonë dhjetor 2005=100).

⁵⁵ Që për qëllim të llogaritjes së normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, ponderohen me një koeficient të caktuar rreziku (20%, 50%, 100%, ose 150%). Në përgjithësi, aktivet me rrezik mbizotërohen nga portofoli i kredisë dhe përfshijnë edhe investimet në letrat me vlerë të borxhit dhe vendosjet pranë institucioneve financiare.


sistemit. Ndër aktivet me rrezik, ato me rrezik të lartë⁵⁶ kapën vlerën 460.5 miliardë lekë.

Vlera e aktiveve me rrezik ishte 5.6% më e lartë kundrejt fundit të vitit 2010 dhe 15.2% më e lartë ndaj të njëjtës periudhë të një viti më parë. Pesa e aktiveve dhe zërave jashtë bilancit me rrezik prej 59.3% e totalit të aktivitetit të sektorit bankar llogaritet pothuaj në të njëjtin nivel me fundin e vitit 2010, por rreth 1.8 pikë përqindje më shumë, referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë. Në vijim paraqitet grafikisht (në formë indeksi) ecuria e aktiveve me rrezik paralelisht me ecurinë e totalit të aktiveve. Evidentohet se ritmi i rritjes së aktiveve me rrezik është dy herë më i lartë se ai i rritjes së totalit të aktiveve, çfarë shpjegohet dhe me peshën


Grafik 70. Diferenca midis aktiveve-pasiveve sipas periudhave të rëçimitit



Grafik 71. Ecuria e aktiveve të ponderuara me rrezik në krahasim me ritmin rritës të totalit të aktiveve



Grafik 72. Aktivët me rrezik për grupet e bankave




e rëndësishme të aktiveve me normë ponderimi 150% rrezik në totalin e tyre (prej 31.9%). Në krahasim me periudhën bazë (Dhjetor 2005=100), aktivet me rrezik rezultojnë të jenë 4-fishuar.

Për sa i takon grupeve sipas madhësisë së aktivitetit, në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2011, raporti i “aktiveve me rrezik ndaj totalit të aktiveve” ka shënuar rritje për Grupin 1 në nivelin 62.4% nga 59.2% në fund të vitit 2010, ndërkohë referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë evidentohet Grupi 3 me rritjen më të madhe të raportit, me rreth 2.2 pikë përqindje në nivelin 55.3%.


⁵⁶ Që për qëllim të llogaritjes së normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, ponderohen me koeficientët e rrezikut 100% dhe 150%. Përfaqësohen kryesisht nga kredia, duke përfshirë edhe kredinë në valutë për huamarrës që kanë të ardhura në lekë.

Grafik 73. Huatë me probleme ndaj totalit të huave



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 74. Huatë me probleme ndaj totalit të huave sipas grupeve



Burimi: Banka e Shqipërisë

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2011, raporti i kredive me probleme ndaj totalit të portofolit të kredisë, mbi baza bruto, u ngjiti në nivelin 17%, kundrejt 13.9% në fund të vitit 2010 dhe 12.2% në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Kreditë me probleme të sektorit bankar u ngjiten në nivelin 88.9 miliardë lekë, duke shënuar rritje të konsiderueshme me rreth 20.4 miliardë lekë ose 29.8% krahasuar me fundin e vitit 2010. Analiza e ecurisë së huave me probleme dhe tepricës së kredisë referuar një periudhe bazë (dhjetor 2005=100), evidenton rritje të huave me probleme me rreth 30 herë më shumë se baza dhe rritje të tepricës së kredisë 4 herë më shumë se baza. Në raport me tepricën e kredisë, huatë me probleme janë rritur me rreth 7.3 herë më shumë. Ritmi më i ngadaltë i rritjes së tepricës së kredisë ka theksuar rënien e cilësisë së portofolit të kredisë.

Për sa i përket grupeve sipas madhësisë së aktivitetit, bankat e përfshira në Grupet 2 dhe 3 kanë shënuar rritjen më të madhe të treguesit “kredi me probleme ndaj totalit të kredive” në krahasim me fundin e vitit 2010, përkatësisht me 3.8 pikë përqindje dhe 2.5 pikë përqindje, duke u ngjitur në nivelet 17.4% dhe 17.1%.

Cilësia e portofolit të kredisë ka shënuar rënie si për bizneset, ashtu edhe për individët. Raporti i kredive me probleme ndaj tepricës së kredisë për bizneset dhe për individët llogaritet përkatësisht 19.1% dhe 13.9%, krahasuar me 15.5% dhe 11.7% në fund të vitit 2010. Gjithashtu, cilësia e portofolit

të kredisë sipas monedhës, është në rënie si për portofolin në lekë ashtu edhe për atë në valutë. Treguesit “kredi me probleme në lekë/tepricës së kredisë në lekë” dhe “kredi me probleme në valutë/tepricës së kredisë në valutë” u llogariten përkatësisht në nivelet 16.7% dhe 17.1%, krahasuar me 14.4% dhe 13.8%, që rezultuan në fund të vitit 2010.


Cilësia e portofolit të kredisë ka shënuar rënie për sektorët kryesorë të ekonomisë referuar një gjashtëmujori më parë dhe të njëjtës periudhë të një viti më parë. Në bazë të llogaritjeve sektori me cilësinë më të ulët për gjashtëmujorin e parë të vitit 2011 është ai i “ndërtimit” ku treguesi i cilësisë është rritur në nivelin 27.6% nga 19.7% në fund të vitit 2010 dhe 15.9% nga periudha e një viti më parë. Ndërkohë, përmirësim të cilësisë së portofolit të kredisë ka shfaqur sektori i “transportit” ku treguesi i cilësisë ra në 14.6% nga 23% në fund të vitit 2010 dhe 17.2% e njëjta periudhë e një viti më parë.

Teprica e kredisë në valutë, ku të ardhurat e huamarrësit janë në lekë, rezultoi rreth 198.6 miliardë lekë, duke përbërë 37.9% të tepricës së kredisë në total dhe rreth 55.2% të tepricës së kredisë në valutë. Sipas monedhave, rreth 89.7% e kësaj kredie është në euro dhe rreth 9.9% është në dollarë amerikan. Kundrejt totalit të tepricës së kredisë në valutë, pjesa e kësaj kredie në euro zë 49.5% dhe ajo në dollarë amerikan zë 5.5%. Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2011, raporti “hua me probleme në valutë, ku kredimarrësi është i pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit/teprica e kredisë në valutë, ku kredimarrësi është i pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit” rezultoi rreth 17.1% kundrejt 12.5% në fund të vitit 2010⁵⁷, çfarë shpjegohet dhe me tkurrjen e këtij portofoli nga bankat e sistemit. Konkretisht, në tremujorin e dytë të vitit 2011, teprica e kredisë në valutë, e pambuluar, u pakësua me rreth 5.9 miliardë lekë ose 2.9%.


Fondet rezervë (provigjonet) për përballimin e humbjeve nga rreziku i kreditit u ngjiten në nivelin 46 miliardë lekë, rreth 27.3% më shumë se niveli i tyre në dhjetor 2010. Raporti i provigjoneve me kredinë me probleme (bruto) ra në nivelin 51.7%, nga 52.7% që llogaritej në fund të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2010, pranë nivelit të mesatares historike 5-vjeçare prej rreth 51%. Raporti i provigjioneve ndaj totalit të tepricës së kredisë (bruto), u ngjit në nivelin 8.8%, krahasuar me 7.4% në fund të dhjetorit 2010 dhe 6.4% një vit më parë.

Cilësia e portofolit të kredisë ka shënuar rënie edhe në termat e kapitalit, në fund të gjashtëmujorit të parë të 2011, duke rezultuar në një mbulim më të ulët me kapital të vlerës së huave me probleme nga sektori bankar. Konkretisht, në nivel mesatar, treguesi “hua me probleme neto ndaj kapitalit” u rrit me 12.5 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit 2011, duke u ngjitur në nivelin 48.8%. Treguesi me rritjen më të madhe është “kredi me probleme neto ndaj kapitalit bazë” me rreth 13.2 pikë përqindje, duke arritur në nivelin 51.3%, nga 38.1% në fund të vitit 2010.

Grafik 75. Cilësia e portofolit sipas sektorëve




Grafik 76. Ecuria e raportit të mbulimit të kredive me probleme me provigjone



⁵⁷ Më konkretisht sipas monedhave i njëjti tregues në euro, për Qershor 2011 rezultoi 17.6% nga 13.3% në Dhjetor 2010. Ndërsa në monedhën amerikane (usd) referuar të njëjtës periudhë, rezultoi 13% nga 6.5% në Dhjetor 2010.

Grafik 77. Hua me probleme ndaj kapitalit bazë




Burimi: Banka e Shqipërisë

Në nivel grupesh sipas madhësisë së aktivitetit, bankat e përfshira në Grupet 2 dhe 3, shfaqën rritjen më të lartë të kredisë me probleme neto ndaj kapitalit bazë. Konkretisht, për bankat e Grupit 2, ky tregues u rrit me 14.2 pikë përqindje krahasuar me nivelin e muajit Dhjetor 2010, duke u ngjitur në 61.1%. I njëjti tregues për bankat e Grupit 3 është rritur me rreth 15.2 pikë përqindje, në nivelin 52.3 %.


Në fund të gjashtëmuajorit të parë të vitit 2011, mbulimi me kolateral⁵⁸ i portofolit të kredisë me probleme llogaritet në nivelin 81.7% e portofolit të kredisë, nga 79.3% që llogaritej në fund të vitit 2010.

Grafik 78. Hua me probleme ndaj kapitalit bazë sipas grupeve të bankave



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 79. Kategoritë e kredisë të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme në përqindje




Burimi: Banka e Shqipërisë

6.2.4 RREZIKU I LIKUIDITETIT


Në fund të gjashtëmuajorit të parë të vitit 2011, raporti i aktiveve likuide me pasivet afatshkurtra (me maturim deri në një vit) rezultoi 30.2%, kundrejt 30.6% në fund të vitit 2010 dhe 32.8% në njëjtën periudhë të një viti më parë. Sipas monedhave, vlera e raportit paraqitet më e lartë për lekun dhe dollarin dhe më e ulët për euron. Konkretisht, për lekun rezultoi 41.2%, për dollarin 28.5% dhe për euron 14.9%. Raporti i aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve ka shënuar rënie në nivelin 25.5% nga 27.8% një vit më parë. Sipas madhësisë së aktivitetit, bankat e Grupit 1 paraqesin rritjen më të madhe të raportit “aktive likuide ndaj pasiveve afatshkurtra” me rreth 2.2 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit 2010, në nivelin 36.5%. Bankat e Grupit 3 shfaqin rënie në të dy treguesit e analizuar më sipër, në krahasim me fundin e vitit

⁵⁸ Kolaterali në formën e pasurive të paluajtshme (rezidenciale, tregtare ose tokë), cash etj.


Grafik 80. Aktivet likuide ndaj totalit të aktiveve për sektorin bankar dhe për grupet e bankave



Grafik 81. Aktivet likuide ndaj totalit të pasiveve afatshkurta për sektorin bankar dhe për grupet e bankave



Grafik 82. Hendeku i maturimit për "deri në 1 muaj" dhe "deri në 3 muaj"



2010

Diferencat midis aktiveve dhe pasiveve sipas strukturave kohore të maturimit⁵⁹, si për zërat e bilancit, ashtu edhe pas përfshirjes së zërave jashtë bilancit, rezultojnë në vlera negative.

Megjithatë, këto diferenca mbulohen disa herë nga vlera e aktiveve likuide, duke paraqitur një aftësi të plotë për pagesën e detyrimeve në momentin e maturimit të tyre. Sidoqoftë, në këtë kuadër nevojitet të monitorohet me kujdes situata e likuiditetit në valutë, veçanërisht ajo në monedhën euro.

Raporti kredi/depozita rezultoi në nivelin 61%, shumë pranë nivelit të fundit të vitit 2010, megjithatë 2.2 pikë përqindje më pak se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në harkun kohor prej një viti, depozitat janë rritur me rreth

⁵⁹ Duke supozuar mbajtjen deri në maturim të aktiveve dhe të pasiveve.

3.9 pikë përqindje më shumë se kredia. Raporti kredi/depozita për veprimet në valutë ka shënuar 87.4%, duke rezultuar 1.5 pikë përqindje më shumë se fundi i vitit 2010 dhe rreth 7.8 pikë përqindje më i ulët se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Raporti kredi/depozita në lekë rezultoi 36.7% nga 35.4% referuar fundit të vitit 2010. Rritja e treguesit ka ardhur si rezultat i një gjallërimi më të madh të kredive në lekë (10.4%) në krahasim me ecurinë e depozitave në lekë (6.5%), nga fundi i vitit 2010.

Një formë tjetër e administrimit të nevojave afatshkurtra për likuiditet është huamarrja në tregun ndërbankar ose nga Banka e Shqipërisë. Përgjithësisht, kjo është një huamarrje e kolateralizuar; lloji së bashku me mjaftueshmërinë e aktiveve, të cilat mund të shërbejnë si kolateral në këtë rast, është një tjetër element, që duhet monitoruar për të vlerësuar aftësinë e bankave mbi plotësimin e nevojave të tyre për likuiditet në afat të shkurtër.

6.2.5 KAPITALIZIMI I VEPRIMTARISË

Kapitalizimi i veprimtarisë përfaqëson qëndrueshmërinë afatgjatë të sektorit bankar. Për këtë, monitorohen treguesit e kapitalit rregullator dhe të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Në fund të muajit qershor 2011, kapitali rregullator⁶⁰ u ngjiti në nivelin 90.6 miliardë lekë, duke shënuar rritje me vetëm 0.5% dhe 4% respektivisht kundrejt fundit të vitit dhe muajit qershor 2010. Kapitali bazë shënoi rënie në nivelin 84 miliardë lekë, rreth 1.2 miliardë lekë ose 1.4% më pak se vlera në fund të vitit 2010, dhe vetëm 1 miliardë lekë ose 1.3% më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kapitali bazë zë 92.7% të kapitalit rregullator. Kjo tregon për qëndrueshmërinë e kapitalit të sektorit bankar dhe për cilësinë e tij mjaft të mirë.

Në fund të gjysmës së parë të vitit 2011, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit, i cili vlerëson mbulimin me kapital të veprimtarive me rrezik të sektorit bankar, rezultoi në nivelin 14.6%, duke qenë rreth 0.7 pikë përqindje më i ulët se në fund të vitit dhe 1.6 pikë përqindje më pak se një vit më parë. Niveli minimal i këtij treguesi i përcaktuar nga kuadri rregullativ është 12%. Shkaku i përkeqësimit të treguesit në fjalë shpjegohet me rritjen e ulët të madhësisë së kapitalit rregullator, pasi tejkalohej nga rritja e aktiveve me rrezik (prej 5.6%). Sipas grupeve të bankave, bankat e Grupit 2 paraqesin nivelin më të ulët të treguesit me 13.5%. Megjithëse, niveli i kapitalizimit i veprimtarisë së sektorit bankar vlerësohet i mirë, nevojat për rritje kapitali të bankave individuale monitorohen me kujdes të vazhdueshëm.

⁶⁰ Përfaqëson një koncept mbikëqyrës, që përbëhet nga kapitali bazë dhe kapitali shtesë. Përfshin kapitalin e paguar, rezervat e ndryshme, rezultatin neto të pashpërndarë, rezultatin neto të periudhës ushtrimore, detyrimet e varura etj.

6.2 VLERËSIM I QËNDRUESHMËRISË SË SEKTORIT BANKAR SIPAS USHTRIMIT TË PROVËS SË REZISTENCËS (STRESS-TEST⁶¹)

Nëpërmjet analizës “stress-test” me vështrim nga e ardhmja vlerësohet stabiliteti i sistemit financiar dhe mjaftueshmëria e kapitalit për sektorin bankar për një hark kohor deri në fund të vitit 2012. Ushtrimi i provës së rezistencës vlerëson ndikimin e situatave makroekonomike në gjendjen financiare të sektorit bankar, duke përjashtuar mundësinë e rritjes së kapitalit të paguar gjatë periudhës së marrë në konsideratë. Në praktikë, situata zakonisht përkeqësohet gradualisht dhe bankat kanë kohë të marrin masat e nevojshme, duke injektuar kapital.

Ky ushtrim përmban dy skenarë: Skenari bazë ndërtohet mbi parashikimin e treguesve ekonomikë dhe financiarë mbështetur kryesisht në ecurinë e tyre historike, ndërsa skenari i rënduar supozon një situatë të “stresuar” me një probabilitet të ulët ndodhjeje, duke u mbështetur në tre goditje të mundshme në ekonominë shqiptare: a) ngadalësim i mëtejshëm i kreditimit; b) rritje e normave të interesit të tregut dhe c) nënçmim i monedhës vendase.


Tabelë 20. Supozimet për ndërtimin e stress- test

	Skenari bazë		Skenari i rënduar	
	2011	2012	2011	2012
Vlera në terma mesatarë				
Rritja vjetore e GDP-së në %	2.96	3.67	2.5	2.4
Rritja vjetore e normave të interesit të tregut	0.1 pp	0.25 pp	2 pp	2 pp
Nënçmimi i Lek-ut kundrejt dy monedhave kryesore (EUR dhe USD) në %	2.05	1.55	20	20
Rritja e parashikuar për tepricën e kredisë në %	10.2	18	5	9

Vlerësimet për treguesin e cilësisë së portfolit të kredisë, në fund të vitit 2011 pasqyrohen grafikisht si më poshtë, sipas të dy skenarëve (deri në tremujorin e dytë 2011 shfrytëzohen vlerat faktike). Sipas grafikut 83, probabiliteti i përballjes me vlera ekstreme (larg mesatares) të raportit të kredisë me probleme është më i lartë në skenarin e rënduar krahasuar me skenarin bazë.


Në vijim, është llogaritur ndikimi i rritjeve të mësipërme të portfolit të kredisë me probleme në madhësinë e kapitalit dhe të aktiveve me rrezik për secilën bankë dhe për sektorin bankar në tërësi.

Grafik 83. Ecuria dhe parashikimi i raportit të kredisë me probleme ndaj totalit të tepricës së kredisë deri në fund të vitit 2012, sipas skenarit bazë dhe të rënduar



Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar

⁶¹ Theksojmë që “stress-test” nuk është një mënyrë parashikimi. Në mënyrë të qëllimshme skenarët përmbajnë zhvillime negative, për të provuar rezistencën e sektorit bankar ndaj tyre. Skenarët përmbajnë supozime që përfaqësojnë zhvillime ekstreme dhe me një probabilitet të ulët ndodhjeje. Megjithatë bankat nxiten që të vlerësojnë kapacitetin e gjendjes së tyre financiare për të përballuar ndikimin e këtyre skenarëve, ato nuk duhet t’i konsiderojnë këto skenarë si ngjarje të pritshme nga ana e Bankës së Shqipërisë për të ardhmen. Skenarët janë të ndryshueshëm përgjatë kohës, në varësi të zhvillimeve ekonomike dhe financiare. Nga ana tjetër, skenarët nuk marrin në konsideratë veprimet që mund të kryejnë bankat për të forcur në vazhdimësi situatën e tyre financiare dhe qëndrueshmërinë ndaj rreziqeve.



Në tabelen në vijim, është pasqyruar ndjeshmëria e bankave të veçanta dhe e sektorit bankar ndaj goditjeve në cilësinë e kredisë, e vlerësuar në terma të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit për fundin e vitit 2011 dhe 2012.

Tabelë 21. Rezultatet e stress-test në terma të kapitalizimit të sektorit bankar

Rezultatet për Fundin e Vitit 2011				
	Skenari 1		Skenari 2	
	Banka	Sektori	Banka	Sektori
Kapitali Rregullator/Totali i Aktiveve me Rrezik		I kapitalizuar		I kapitalizuar
Nënkapitalizim Modest /1	Po		Po	
Nënkapitalizim i Rëndë /2	Po		Po	
Kapitali Bazë/Totali i Aktiveve me Rrezik		I kapitalizuar		I kapitalizuar
Nënkapitalizim Modest /3	Po		Po	
Nënkapitalizim të Rëndë /4	Po		Po	

/1 = Nën raportin prej 12%;

/2 = Nën raportin prej 6%;

/3 = Nën raportin prej 6%;

/4 = Nën raportin prej 3%.

Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar

Tabelë 22. Rezultatet e stress-test në terma të kapitalizimit të sektorit bankar

Rezultatet për Fundin e Vitit 2012				
	Skenari 1		Skenari 2	
	Banka	Sektori	Banka	Sektori
Kapitali Rregullator/Totali i Aktiveve me Rrezik		I kapitalizuar		I kapitalizuar
Nënkapitalizim Modest /1	Po		Po	
Nënkapitalizim i Rëndë /2	Po		Po	
Kapitali Bazë/Totali i Aktiveve me Rrezik		I kapitalizuar		I kapitalizuar
Nënkapitalizim Modest /3	Po		Po	
Nënkapitalizim të Rëndë /4	Po		Po	

/1 = Nën raportin prej 12%;

/2 = Nën raportin prej 6%;

/3 = Nën raportin prej 6%;

/4 = Nën raportin prej 3%.

Në përfundim, ushtrimi i provës së rezistencës tregon se në tërësi, sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm ndaj goditjeve të forta makroekonomike, të cilat ndikojnë në përkeqësimin e portofoleve të kredive të bankave dhe për pasojë në rritjen e shpenzimeve për provigjione, rënien e rezultatit financiar dhe rënien e pozicionit të kapitalizimit të veprimtarisë. Por ndjeshmëria e bankave të veçanta ndaj goditjeve të supozuara është rritur, ndaj bankat duhet të vlerësojnë përshtatshmërinë e treguesve të kapitalizimit të veprimtarisë dhe të fuqizojnë pozicionet e tyre të kapitalit.